



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:087301

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05631379

KPPP.nr.739/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Egzoni” SH.P.K., me NUI:810603169, me seli në Prizren, fshati Piranë, kundër debitorit “Hidroterm” SH.P.K., me NUI:810634867, me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.34/2020 datë 15.01.2020, të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Hidroterm” SH.P.K., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.34/2020, i datës 15.01.2020, i Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 6,608.00 € (gjashtëmijë e gjashtëqind e tetë euro).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.34/2020, i datës 15.01.2020, i Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, sa i përket kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8% nga data kur kërkesa është bërë e arritshme për pagesë datë 14.12.2019, e deri në pagesën definitive me datë 28.12.2021, si dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “Egzoni” SH.P.K., ndaj debitorit “Hidroterm” SH.P.K., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.34/2020, të datës 15.01.2020, për shumën prej 6,608.00 € (gjashtëmijë e gjashtëqind e tetë euro).

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.34/2020, të datës 15.01.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 19-SHV01-001-17, të datës 04.12.2019, duke urdhëruar debitorin që nga dita e pranimit të urdhrin ti paguaj kreditorit shumën prej 6,608.00 €, me kamatë 8%, nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, ashtu që përmbartimi të realizohet me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale të Kosovës.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se e kundërshton urdhrin përmbartimor, për shkak se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk ka titull përmbartimor, si i tillë nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Tutje ka shtuar se fatura e nënshkruar nuk paraqet çështje të saktë të borxhit, kreditori do të duhej të bisedonte me debitorin për të përcaktuar shumën e saktë për pagesë. Gjykatës i ka propozuar që ta hedh poshtë propozimin për përmbartim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit për faktin se dokumenti i besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar procedura përmbartimore, është dorëzuar në origjinal në shkresat e lëndës, është e nënshkruar andaj e njëjta i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se shërbimet kreditori i ka kryer për debitorin, debitori nuk ka paraqitur asnjë provë, dhe nuk plotësohen shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me Aktvendimin PP.nr.10/2020 të datës 25.03.2021, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, e ka anuluar urdhrin përmbartim si dhe e ka përfunduar procedurën përmbartimore.

Kreditori me datë 14.04.2021, ka ushtruar ankesë kundër Aktvendimit PP.nr.10/2020 të datës 25.03.2021, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovoj ankesën e kreditorit, ta anuloj aktvendimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje .

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.3339/2021 të datës 18.03.2022, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe ka anuluar aktvendimin PP.nr.10/2020 të datës 25.03.2021, të Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosi pranë të njëjtës gjykatë.

Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, me Aktvendimin PP.nr.77/2022 të datës 21.07.2022, e ka përfunduar procedurën përmbartimore për shkak të përmbushjes së borxhit kryesor.

Kundër Aktvendimi të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, kreditori ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë përmes prokurorit të shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML.nr.20/2020, të datës 21.02.2023, e ka pranuar si të bazuar kërkesën e prokurorit të shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ka anuluar Aktvendimin PP.nr.77/2022 të datës 21.07.2022 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, P.nr.34/2020, të datës 15.01.2020, sipas Faturës Nr. 19-SHV01-001-17, të datës 04.12.2019, është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit. Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që debitori përmes parashtrësës së datës 20.06.2022, ka njoftuar gjykatën se ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit, duke bashkangjitur si provë dëshmitë e pagesave me numër Ref. 568303006 të

datës 28.12.2021 në shumë prej 3,108.00 € dhe dëshminë e pagesës me numër Ref. 562796762 të datës 28.10.2021 në shumën prej 3,500.00 €.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin, sepse e njëjta është përmbushur në tërësi nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 6,608.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur fatura është bërë e arritshme për pagesë datë 14.12.2019 e deri në pagesën definitive përkatësisht deri me datën 28.12.2021.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifata tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, P.nr.34/2020, të datës 15.01.2020. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përmbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përmbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas*

përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit si rrjedhojë e përmbushjes së borxhit kryesor të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbarimor e la në fuqi, sa i përket pjesës së kamatës dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.739/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.